



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 6038 Prot.

Roskovec, më 30.07.2024

NJOFTIM

PËR

**VEND TË LIRË PUNE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN (MZSH)**

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Kreu i III “Ndarja e Funksioneve, nivelet, detyrat, procedurat e përzgjedhjes për emërim, lirim pezullim dhe përjashtim”; VKB Nr. 108, datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2024”; VKB Nr. 109, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 1298/1 prot. datë 04.01.2024; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 2, datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat Përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, si dhe organigramës për vitin 2024”, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit njofton se në Sektorin e MZSH-së shpallet vend i lirë pune:

1 (një) pozicion - Punonjës zjarrfikës “Luftues-shpëtues” (niveli bazë)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Luftuesi /shpëtuesi /evakuuesi /drejtuesi i automjeteve dhe punonjësi në sallën operuese është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale. Të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambientet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";

Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Bashkisë Roskovec + Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së (bashkëlidhur).
2. Fotokopje e kartës së identitetit ;
3. Çertifikatë familjare;
4. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
6. Fotokopje e noterizuar diplomë shkollës së lartë+ listë notash apo deftesë pjekurie (të arsimit të mesëm minimalisht).
7. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
8. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
9. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)/ Formular vetëdeklarimi ;
10. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
11. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
12. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C";
13. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
14. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) copë

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi në sportelet e Zyrës me një ndalesë në Bashkinë e Roskovecit apo me postë brenda datës 16.08.2024.

Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraparak

Në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, Njësia përgjegjëse e Burimeve Njerëzore Bashkia Roskovec do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave të mëtejshme të konkurrimit (Testim me shkrim; Testim i aftësive fizike; Intervistë me gojë; Testimi psikologjik).

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **2 (dy) ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

Fushat kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin’.
- VKM nr. 520 dt.25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë **70% të pikëve** të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

- Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi **60%** të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit do të shpallë fituesit në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec dhe në standat e informimit të publikut.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

KRYETARI I BASHKISË

Majlinda Bufi

